



# Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

**korrik - tetor 2016**



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Институт за демократија  
Социетас цивилис - Скопје

# Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin (korrik - tetor 2016)

Instituti për demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS) nga qershori i vitit 2014 e përcjell cilësinë e debatit në Kuvendin. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua gjatë 10 muajve, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015<sup>1</sup>. Nga shtatori i vitit 2015 monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së debatit parlamentar vazhdon i përkrahur nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe do të zgjas deri më dhjetor të vitit 2017.

Monitorimi në këtë periudhë fokusohet në diskutimet që kanë të bëjnë me rendin kuvendor të ditës të cilat bëjnë pjesë në sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe demokracinë. Në këtë drejtim monitorohen të gjitha ato trupa kuvendore në fushëveprimin e të cilave bëjnë pjesë këto tema. Në mënyrë shtesë, në kuadër të projektit janë të përfshira edhe mediet, përkatësisht përcillet se si ato raportojnë për punën e Kuvendit.

Gjatë monitorimit gjetjet për cilësinë e debatit në Kuvendin dhe për raportimin mediatik publikohen në formë të raporteve tremujore. Para jush është për cilësinë e debatit në Kuvendin i cili ka të bëjë me periudhën nga 1 korriku deri më 17 tetor të vitit 2016, përkatësisht periudha e fundit e punës së përbërjes së fundit parlamentare.

## Rezyme

Në argumentet e drejtuara nga deputetët e tjerë, folësit më shpesh zgjedhnin të përgjigjen vetëm në një pjesë të argumenteve, ti informojnë ose ti shtrembërojnë se sa në mënyrë të drejtpërdrejtë të ballafaqohen me argumentet dhe të përgjigjen. Deputetëve të opozitës u shkojnë 71% të rasteve kur deputetët në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjigjeshin në argumentet e drejtuara. Deputetëve të shumicës u shkojnë 71% të diskutimeve në të cilat diskutuesit tërësisht i shtrembërojnë argumentet dhe 66% të rasteve në të cilat i injorojnë argumentet e drejtuara.

Konstantë mbetet mos-ndryshimi i qëndrimeve dhe pozicioneve të deputetëve gjatë diskutimeve. Kjo vë në pah pozitën e forta fillestare të deputetëve para se të hynë në sallat parlamentare dhe fleksibilitet i vogël për ndryshim të pozicioneve përkatësisht një mbyllje ndaj qëndrimeve të folësve të tjerë. Në 50% të rasteve folësit aspak nuk e njohën vlerën e argumenteve të folësve të tjerë.

Vëmendje më të madhe te deputetët shkaktuan diskutimet rreth financave publike, përkatësisht fillimisht rreth ri-balancimit të Buxhetit për vitin 2016, e mandej edhe rreth miratimit të buxhetit për vitin 2017 dhe debatet rreth vërshimit në rajonin e Shkupit.

Sipas llojit të diskutimit është rritur pjesëmarrja e fjalimeve në debatet parlamentare, ndërsa është zvogëluar pjesëmarrja e replikave dhe kundër – replikave. Në këtë periudhë 31% të diskutimeve ishin fjalime gjë e cila është përqindja më e lartë deri tani krahasuar me periudhat e monitoruara

---

<sup>1</sup> Cikli i parë i cilësisë së debatit dhe të raportimit mediatik u zhvillua në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz. Përforsimi i debatit politik dhe i diskursit deliberativ” i financuar nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – EIDHR dhe i bashkë-financuar nga IDSCS dhe IEKOB. Raportin e plotë për cilësinë e debatit në ciklin e parë të vëzhguar i cili e përfshiu periudhën nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015 është i qasshëm në linkun vijues: <http://idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/rovovska-debata-mk.pdf>

paraprake. Kjo sipas të gjitha gjasave ka të bëjë me dy debatet buxhetore në të cilat folësit kishin kohë më të gjatë në dispozicion për debate.

Në periudhën nga 1 korriku deri më 17 tetor të vitit 2016 u rrit argumentimi i diskutimeve gjë e cila në pjesën më të madhe ka të bëjë me përqindjen më të gjatë për diskutim të cilën deputetët e kishin në dispozicion në dy debatet buxhetore. Më tepër se dy argumente janë identifikuar në 9%, dy argumente në 13% dhe një argument në 42% të diskutimeve që është niveli më i lartë krahasuar me të gjitha periudhat paraprakisht të monitoruara. Me këtë rast deputetët opozitarë kanë pjesëmarrje më të madhe në të gjitha shkallët e argumentimit.

Deputetët më shpesh shprehnin forma të ndryshme të mos – respektimit ndaj personalitetit të kolegëve të tyre, se sa ndaj argumenteve të tyre. Respektim është shprehur vetëm në 4% të rasteve, ndërsa respektim i pjesshëm në madje 39% të rasteve. Në 6% është shënuar mos – respektim i plotë, përkatësisht folësit në diskutimet e veta kanë përdorur fjalor fyes dhe shprehje ose sulme ndaj personalitetit ose partisë së deputetëve të tjerë.

Në 11% të diskutimeve është vërejtur ndërprerje në diskutimet e folësve nga deputetët të tjerë. Ato janë ndërprerje në kohëzgjatje prej më së shumti 10 sekonda të shkaktuara më shpesh me bërtitje ose ndërhyrje ndaj folësve nga deputetë që rrinë anësh dhe të cilët në atë moment nuk e kanë marrë fjalën. Pas ndërprerjeve folësit i kanë vazhduar diskutimet e veta. Në 7% të rasteve deputetë vunë në pah se kanë qenë të penguar që t'i shprehin qëndrimet e veta nga foltoret.

Deputetët nga opozita ishin më aktiv në diskutimet rreth temave të monitoruara. Në diskutuesit nga opozita shkojnë 60% të diskutimeve, ndërsa 40% diskutimet e tjera janë të shumicës.

## Konteksti politik

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Parti demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO – DPMNE) fitoi 61 deputet, ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e themeluan Qeverinë, Bashkimi Demokratik për integrim (BDI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë e Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK). Deputeti i cili mandatin e vet e fitoi nga RDK edhe krahas vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin iu bashkëngjiti grupit të deputetëve të BDI-së. Me atë, tani grupi i deputetëve i BDI-së numëron 20 deputetë. Më 8 maj partia Përtëritja demokratike për Maqedoninë (DOM) e cila ka një deputet (Liljana Popovska) në Kuvendin, vendosi ta braktis koalicionin pushtet-mbajtës. Në periudhën nga 20 qershori i vitit 2014 deri në fund të gushtit të vitit 2015, deputetët e koalicionit më të madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotoi punën e Kuvendit. Nga 1 shtatori i vitit 2015 deputetët e koalicionit të LSDM u kthyen në parlamentin dhe morën pjesë në punën e tij.

Nga 1 shtatori i vitit 2015 koalicioni opozitar i udhëhequr nga koalicioni opozitar të udhëhequr nga LSDM u kthye në Kuvendin dhe punoi në përbërje të plotë deri në vendimin për shpërbërje të tij të votuar më 7 prill të vitit 2016 me qëllim të mbajtjes së zgjedhjeve më 5 qershor të vitit 2016. Më 18 maj të vitit 2016 pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese që ti ndërpres veprimet zgjedhore dhe ta shqyrtojë kushtetutshmërinë e zgjedhjeve të shpallura, Kuvendi të njëjtën ditë me shumicë vendosi ta shtyjë për kohë të pacaktuar datën e mbajtjes së zgjedhjeve. Në periudhën e monitoruar dhjetor 2015 – prill 2016 shumica në pushtet në Kuvendin numëron 81 deputetë, ndërsa opozita 42 deputetë.

Prej 14 janarit të vitit 2016 në krye të Qeverisë është i ashtuquajtur kryeministër “teknik” Emill Dimitriev, në vend të liderit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski. Në periudhën të cilën e përfshin ky raport, partitë politike u pajtuan se ekzistojnë kushte minimale për realizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor të vitit 2016 me të cilat do të duhet të fillojë ç’thurja e krizës politike. Periudha e tërësishme në parlamentin kaloi në shenjën e zgjedhjeve të ardhshme dhe me pozicionimin e partive për çështje të ndryshme të cilat e preknin opinionin dhe të cilat buronin nga marrëveshjet politike. Në këtë periudhë para Parlamentit raport paraqiti Prokurorja Publike speciale, Katica Janeva, që mandej, shumica parlamentare në vigjilje të shpërbërjes së parlamentit të refuzojë të votojë për vazhdim të mandatit të kësaj prokurorie e cila ka kompetencë që ti hetojë rastet të cilat dolën nga bisedimet e përgjuara të publikuara. Deputetët para shpërbërjes së parlamentit e miratuan edhe Buxhetin për vitin 2017. Opozita hoqi dorë diskutim thelbësor për Buxhetin për të mos u tejkalar afati për shpërbërje të parlamentit, gjë e cila do të mund të rezultonte me shtyrje edhe të zgjedhjeve. Këtë periudhë të monitoruar e karakterizoi edhe stuhia e madhe në rajonin e Shkupit e cila mori njëzet jetë njerëzish dhe shkaktoi dëm të madh material. Fatkeqësia rezultoi me debate parlamentare për motin e lig dhe për mënyrën me të cilën shërbimet shtetërore ballafaqoheshin me pasojat<sup>2</sup> ndërsa opsionet e kundërshtuara politike nuk arritën qëndrime të përbashkëta, gjë e cila në mënyrë shtesë e polarizoi atmosferën edhe ashtu të tendosur. Kuvendi mbajti mbledhje deri më 17 tetor të vitit 2016.

## Gjetje nga monitorimi

### Lloji i diskutimeve

Në periudhën nga 1 korriku deri më 17 tetor të vitit 2016 në përgjithësi vazhdoi të zvogëlohet shpeshtësia e punës së Parlamentit duke pasur parasysh se data për mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare ende nuk ishte e sigurt. Në këtë periudhë janë analizuar gjithsej 755 diskutime të deputetëve në lidhje me 17 pika nga rendi i ditës së Kuvendit të cilat hynë në sferat vijuese<sup>3</sup>.

Sipas diskutimeve, kjo periudhë është karakteristike për shkak se vëmendje më të madhe te deputetët shkaktuan rreth financave publike fillimisht rreth ri-balancimit të Buxhetit për vitin 2016, e mandej edhe rreth miratimit të Buxhetit për vitin 2017.. Prej tyre, 45% janë nga debati për ri-balancimin e Buxhetit për vitin 2016, ndërsa 10% në debatin për Buxhetin për vitin 2017. Sipas numrit të lartë të diskutimeve, temë e dytë e cila më së shumti e tërhoqi vëmendjen e deputetëve në këtë periudhë ishte vërshimi në rajonin e Shkupit. Në këtë temë shkojnë 15% nga numri i tërësishëm i diskutimeve të analizuar. Në vendin e tretë sipas diskutimeve është zgjedhja e ministrave të ri të punës dhe politikës sociale dhe të punëve të brendshme dhe të zëvendës ministrave për bujqësi dhe administratë nga opozita si obligim i Marrëveshjes së Përzahinos me pjesëmarrje prej 6% në numrin e tërësishëm të fjalimeve të analizuar.


Sipas përkatësisë politike të diskutuesve në periudhën e fundit të monitoruar rezulton se deputetët nga opozita ishin më aktiv në diskutimet rreth temave të monitoruara. Në diskutuesit opozitar shkojnë 60% të diskutimeve, ndërsa 40% të tjerat janë të deputetëve nga shumica në pushtet. Në monitorimin

<sup>2</sup> Debati në dy seancat kuvendore në të cilat u diskutua për vërshimet janë të përfshirë në mënyrë shtesë në analizën “Partia më e fuqishme nga moti i keq” :


<http://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2016/12/Analiza-na-sobraniskite-sednici-posveteni-na-poplavite-.pdf>

<sup>3</sup> Komisioni për financim dhe buxhet, Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive, Komisioni anketues për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të qytetarit, Komisioni anketues për skandalin me përgjimet, Komisioni për mbikëqyrje të masës së posaçme hetimore përcjellje e komunikimeve nga Ministria e punëve të brendshme, Drejtoria e policisë financiare, Drejtoria e doganave dhe Ministria e mbrojtjes dhe Komisioni për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundër-zbulim si dhe të Agjencisë për zbulim.


e deritanishëm, deputetët nga shumica ishin më aktiv nga opozita vetëm në një periudhë të monitoruar përkatësisht në periudhën nga 7 prilli deri më 30 qershor të vitit 2016.



Sipas llojit të diskutimeve në periudhën prej 1 korrikut deri më 17 tetor u rrit pjesëmarrja e fjalimeve në debatet parlamentare, ndërsa u zvogëlua pjesëmarrja e replikave dhe kundër-replikave. Në këtë periudhë 31% të diskutimeve ishin fjalime, gjë e cila është përqindja më e lartë deri tani e krahasuar me periudhat paraprakisht e monitoruar. Sipas Rregullores së Kuvendit kohëzgjatja e lejuar e një fjalimi është 10 minuta, por gjatë diskutimeve për Buxhetin anëtarët e komisionit kompetent për financa dhe buxhet kanë të drejtë për më tepër diskutime në kohëzgjatje prej 20 minuta, ndërsa koordinatori i grupit parlamentar deri 30 minuta. Në këtë periudhë të monitoruar deputetët dy herë debatuan për financat publike përkatësisht për ri-balancimin e Buxhetit për vitin 2016 dhe për Buxhetin për vitin 2017 gjë e cila edhe solli rritje të përfaqësimit të fjalimeve. Duke e pasur parasysh këtë, pjesëmarrja e replikave – 34% dhe kundër-replikave – 33% u zvogëlua në nivelin më të ulët krahasuar me të tri periudhat paraprakisht të monitoruara.




Nëse analizohet sipas përkatësisë politike të folësve edhe në periudhën e fundit vazhdon trendi nga periudhat paraprake të folësve nga opozita të shkojnë pjesa më e madhe e fjalimeve (82%) dhe kundër-replikat (71%), ndërsa në folësit nga shumica shkon pjesa dominante e replikave (70%).




## Shkallë e argumentimit


Monitorimi i diskutimeve kuvendore në periudhën prej 1 korriku deri më 17 tetor të vitit 2016 tregoi se në seancat që u mbajtën në këtë periudhë deputetët ishin më të argumentuar krahasuar me periudhat paraprake. Kjo s[ri]sh në pjesë të madhe mund të ketë të bëjë në përqindjen më të madhe të fjalimeve të fjalimeve për shkak të diskutimeve të cilën deputetët e kishin në dispozicion në dy debatet buxhetore. Deputetët në fjalimet që mund të zgjasnin 10 minuta, përkatësisht deri 30 minuta kur debatohet për Buxhetin, kanë më tepër kohë të zhvillojnë argumentim më të gjerë me të cilin i arsyetojnë dhe i mbështesin pozitat e veta. Kësaj rrethanë mund ti përshkruhet edhe pjesëmarrja e shtuar e diskutimeve në të cilat janë të identifikuar më tepër se dy argumente, dy argumente ose një argument krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara - 9%, dy argumente - 13% dhe një argument - 42% janë në nivel më të lartë krahasuar me të gjitha periudhat paraprakisht të monitoruara.




Sipas përkatësisë politike deputetët e opozitës kanë pjesëmarrje më të madhe në të gjitha shkallët e argumentimit. Te folësit nga opozita prej tyre shkojnë 65% nga rastet në të cilat janë të identifikuar më tepër se 2 argumente dhe 62% të diskutimeve me 1 argument. Në diskutuesit opozitar shkojnë edhe 59% të diskutimeve me arsyetim të dobët dhe 51% të diskutimeve pa arsyetim.



Në raport me atë se si deputetët përgjigjen në argumentet e drejtuara nga folësit e tjerë rezultojnë në këtë periudhë të monitoruar (1 korrik – 17 tetor i vitit 2016) ata më shpesh zgjedhnin tu përgjigjen vetëm në një pjesë të argumenteve, t'i injorojnë ose shtrembërojnë se sa në mënyrë të drejtpërdrejtë të ballafaqohen me argumentet dhe të përgjigjen. Kështu, folësit në mënyrë të drejtpërdrejtë u përgjigjen argumenteve të drejtuara vetëm në 13% të rasteve. Në 23% të diskutimeve diskutuesit zgjedhnin tu përgjigjen vetëm një pjesë të argumenteve të cilat ishin drejtuar ndaj tyre, ndërsa pjesën tjetër ose e shtrembëronin ose e injoronin. Në 8% të rasteve i shtrembëronin tërësisht, ndërsa në 14% i injoronin tërësisht argumentet që u janë drejtuar atyre nga folësit e tjerë.




Analizuar në sajë të përkatësisë politike të diskutuesve rezultojnë se 71% të rasteve në të cilat përgjigjen në mënyrë të drejtpërdrejtë në argumentet e drejtuara u shkojnë deputetëve opozitar. Deputetëve të shumicës u shkojnë 71% të diskutimeve në të cilat folësit tërësisht i shtrembërojnë argumentet që u janë drejtuar nga deputetë të tjerë. Gjithashtu, deputetëve të shumicës u shkojnë edhe 66% të rasteve në të cilat folësit tërësisht i injorojnë argumentet e drejtuara. Deputetëve të shumicës u shkojnë edhe 55% të diskutimeve në të cilat deputetët në mënyrë selektive ju përgjigjen argumenteve, përkatësisht përgjigjen vetëm në një pjesë, ndërsa pjesa tjetër ose e injorojnë ose e shtrembërojnë.




### Fuqia e argumentit më të mirë dhe në emër të kujt paraqiten argumentet

Sërish si në të gjitha periudhat e deritanishme të monitorimit të cilësisë së debatit parlamentar mbetet konstant mos – ndryshimi i qëndrimeve dhe pozicioneve gjatë diskutimeve. Ndryshimi i pozicionit është përjashtim i rrallë gjë e cila vë në pah pozitën e forta fillestare të deputetëve para se të hynë në sallat parlamentare dhe fleksibilitet të ulët për ndryshim të pozicioneve paraqesin qëndrim të mbyllur ndaj diskutuesve të tjerë. Kjo pasqyrohet në atë që edhe në këtë periudhë të monitoruar (1 korrik – 17 tetor të vitit 2016) nuk është shënuar asnjë rast kur folësi ka vënë në pah se e ndryshon pozicionin e vet për shkak të argumenteve më të mira të prezantuara nga folësit e tjerë. Gjithashtu nuk është vërejtur asnjë rast në të cilin folësi ka vënë në pah se e ndryshon pozicionin e vet për shkaqe të tjera. Në këtë periudhë, ngjashëm edhe si në periudhat paraprake, të rralla ishin edhe diskutimet në të cilat folësit mbeten në pozicionin e vet, por prapëseprapë shfaqin se e njohin vlefshmërinë e argumenteve të rivalëve të vet të cilët shkojnë 6% të diskutimeve. Në pjesën më të madhe të diskutimeve folësit mbetën në pozicionin e vet, e me këtë rast nuk e njohin vlefshmërinë e argumenteve të pjesëmarrësve të tjerë në debatin – 50%. Në 43% të rasteve folësit aspak nuk u bënë vështrim me ndonjë vlerësim bashkëbiseduesve të vet në sallat parlamentare.






Nëse kjo kategori analizohet sipas përkatësisë politike të diskutuesve, rezulton se deputetët edhe nga pushteti edhe nga opozita kanë paraqitje të njëjtë të mbyllur ndaj kolegëve nga grupet e kundërshtuara politike në Kuvendin. Te deputetët e opozitës shkojnë 52% të diskutimeve në të cilat folësit mbeten në pozicionet e veta dhe me këtë rast nuk e pranojnë vlefshmërinë e argumenteve të oponentëve të vet, dhe 48% të deputetëve nga shumica. Gjithashtu te deputetët e opozitës shkon pjesa më e madhe – 70% nga diskutimet në të cilat folësit aspak nuk i vështrojnë argumentet e folësve të tjerë.




Në periudhën e fundit te deputetët më shpesh i ndërlidhnin argumentet me përfitime ose pasoja për të gjithë qytetarët përkatësisht me të mirën e përgjithshme - 37%. Folësit pothuajse asesi nuk i ndërlidhnin argumentet ma parime abstrakte si drejtësi sociale, paqe, mirëqenie. Në 17% nga rastet deputetët i ndërlidhnin argumentet e veta me përfitime ose pasoja për grupin e vet me të cilën nënkuptohet grup politik, etnik, fetar, social ose grup profesional me të cilin identifikohet folësi, e në të njëjtën përqindje (17%) edhe me grupe të tjera me të cilat nuk identifikohen folësit. Në 29% nga rastet folësit kanë qenë neutral përkatësisht nuk i ndërlidhën argumentet me përfitime ose pasoja për cilin do qoftë grup në shoqërinë.




Analizuar sipas përkatësisë politike të folësve, në deputetët e opozitës shkon pjesa më e madhe e diskutimeve në të cilat argumentet ndërlidhen me grupin e vet etnik, politik, religjioz ose social – 81%. Pjesa më e madhe e diskutimeve në të cilat folësit i ndërlidhnin argumentet e veta me pasojat ose

përfitimet e të gjithë qytetarëve përkatësisht me të mirën e përgjithshme gjithashtu u takojnë deputetëve të opozitës – 58%. Deputetët edhe nga pushteti (48%) edhe nga opozita (52%) pothuajse në mënyrë të barabartë i ndërlidhin argumentet e veta edhe me grupet e tjera.




## Respekt, ndërprerje, kufizime dhe gjestikulime


Sipas sjelljes së folësve ndaj personaliteteve dhe ndaj argumenteve të deputetëve të partive të tjera rezulton se edhe në periudhën 1 korrik – 17 tetor të vitit 2016 atmosfera në Kuvendin mbeti e polarizuar. Deputetët më shpesh shprehnin forma të ndryshme të mos – respektimit ndaj personalitetit të kolegëve të vet nga opsionet e kundërta politike, se sa ndaj argumenteve të tyre. Në të dy kategoritë është vërejtur zvogëlim i shfaqjes së respektit themelor ndaj argumenteve dhe ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë krahasuar me periudhat paraprakisht të monitoruara. Kështu në raport ndaj argumenteve të deputetëve nga partia tjetër respekt është shfaqur vetëm në 2% të diskutimeve që është përqindje më e vogël deri tani. Në 19% folësit kanë shfaqur respektim të pjesshëm që do të thotë se në pjesën më të madhe të diskutimeve kanë qenë korrekt, por në pjesën më të vogël kanë shfaqur formë më të butë të mos - respektimit. Në 5% të rasteve tek folësit është vërejtur mos – respektim i pjesshëm. Kjo do të thotë se në pjesën më të madhe të diskutimeve të tyre është vërejtur mos – respektim ndaj argumenteve të deputetëve të tjerë, por në pjesën më të vogël diskutimet janë korrekte. Në 3% nga diskutimet është vërejtur mos – respektim i plotë. Kjo do të thotë se në tërë diskutimin folësit kanë shprehur mos – respektim ose në kuadër të diskutimit me fjalor fyes ose të pa hijshëm u bënë vështrim argumenteve të deputetëve të tjerë. Në 71% nga rastet deputetët nuk shfaqën kurrfarë sjellje të respektimit ose mos – respektimit ndaj argumenteve të folësve të tjerë. Shprehja e formave të ndryshme të mos – respektimit ndaj argumenteve mund ta ndryshojë atmosferën eventualisht korrekte e cila është parakusht për zhvillim të debatit racional dhe të argumentuar, për ta ndryshuar vazhden e diskutimit dhe fokusin e deputetëve nga argumentet drejtë sulmeve dhe fyerjeve me çka në mënyrë shtesë polarizohet atmosfera dhe pamundësohet debatit thelbësor.




Shikuar përmes prizmit të përkatësisë politike të folësve të cilët shfaqën ndonjë farë raporti ndaj argumenteve të deputetëve të tjerë, te deputetët e shumicës shkon pjesa më e madhe e rasteve në të cilat është shfaqur respektim - 73%, por edhe ato në të cilat është shfaqur mos – respektim i plotë - 54%. Në këtë periudhë, deputetët edhe nga pushteti edhe nga opozita pothuajse në numër të njëjtë të rasteve shfaqën respektim të pjesshëm dhe mos – respektim të pjesshëm. Te deputetët nga opozita janë pjesa më e madhe e diskutimeve në të cilat nuk është shfaqur kurrfarë raporti ndaj argumenteve të folësve të tjerë - 65%.



Deputetët ishin më eksplicit kur bëhej fjalë për raportin ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë. Folësit, në pjesën më të madhe të diskutimeve, shfaqën ndonjë farë raporti ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë. Me këtë rast, respektim është shfaqur vetëm në 4% nga rastet, ndërsa respektim i pjesshëm në madje 39% nga rastet. Kjo do të thotë se deputetët në pjesën më të madhe të diskutimeve nuk rezistuan e të mos përdorin shprehje dhe sulme të buta përqeshjeje ose sulme më të buta ndaj personalitetit të kolegëve të vet nga opsionet e kundërta politike. Në 10% nga rastet është vërejtur mos – respektim i pjesshëm që do të thotë se folësit në pjesën më të madhe të diskutimeve drejtuan sulme dhe fyerje, ndërsa në pjesën më të vogël të diskutimeve ishin korrekt ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë. Në 6% të rasteve është shënuar mos – respektim i plotë, përkatësisht folësit në diskutimet e veta shfaqën mos – respektim të plotë ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë duke përdorur fjalë, shprehje dhe sulme fyese. Në 41% nga rastet deputetët nuk shfaqën kurrfarë raporti ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë.



Në sjelljen ndaj personalitetit të deputetëve të tjerë, te diskutuesit nga opozita shkon pjesa më e madhe e rasteve në të cilat është shfaqur mos – respektim i plotë 54% krahasuar me shumicën - 46%. Te opozitarët gjithashtu është vërejtur pjesa më e madhe e rasteve në të cilat është shprehur respektim i pjesshëm (58%) dhe mos – respektim i pjesshëm (58%). Te deputetët nga pushteti janë vërejtur pjesa më e madhe e rasteve në të cilat është shfaqur respektim ndaj personalitetit të deputetëve nga opsioni i kundërt politik - 57%. Pjesa më e madhe e rasteve në të cilat folësit nuk i kanë bërë vështrim ndaj personalitetit të ndonjë personaliteti tjetër shkojnë te opozita – 64%.




Deputetët edhe në këtë njëlloj si edhe në periudhat paraprake rrallë përdornin rrëfenja, anekdota ose shaka në diskutimet e veta. Prapëseprapë elemente të tilla janë vërejtur në gjithsej 10% të diskutimeve gjë e cila është më shumë se dyfish më shpesh krahasuar me periudhën paraprake 97 prill – 30 qershor të vitit 2016) kur elemente të tilla u konstatuan në vetëm 4% të rasteve. Rrëfenjat, anekdotat, shakatë ose përvojat në 7% të rasteve janë përdorur nga folësit si plotësim ose përforcim i argumenteve ose të pozicioneve. Në 3% të rast, anekdotat ose dëshmitë janë përdorur si arsytim i vetëm.

Në 11% të diskutimeve është shënuar ndërprerje në diskutimet e folësve nga deputetë të tjerë. Ato janë ndërprerje në kohëzgjatje prej më së shumti 10 sekonda të shkaktuara më shpesh me bërtitje nga vendi ndaj diskutuesve nga deputetë të cilët në atë moment nuk e kanë fjalën. Pas ndërprerjes folësit e kanë vazhduar fjalimin e vet.

Në 7% të rasteve deputetët kanë vënë në pah se janë penguar që ti prezantojnë qëndrimet e veta nga folësit.

## Demografia e folësve, propozues i aktit dhe procedura në të cilën shqyrtohet ligji

Struktura demografike e diskutuesve, diskutimet e të cilëve janë analizuar në periudhën nga 1 korriku deri më 17 tetor të vitit 2016 është me sa vijon:



Në periudhën e monitoruar diskutimet e deputetëve janë prezantuar në seancat në të cilat pikat e rendit të ditës ishin:

**Lloji i aktit:** propozim - ligj 7%, ndryshime dhe plotësime të ligjit 52%, pyetje të deputetëve 4% dhe akte të tjera 34%; pyetje të deputetëve 4%;

**Propozues:** deputetë 35%, Qeveria 60% dhe të tjerë 5%;

**Procedurë në të cilën shqyrtohet:** Në procedurë të rregullt 97%, në procedurë të shkurtuar 3%.

## Metodologjia e hulumtimit

Cilësia e diskutimit në Kuvendin analizohet me përdorimin e “Indeksit të cilësisë së debatit”. Indeksi është instrument i cili mundëson që çdo akt i veçantë i fjalimit në seancën e monitoruar të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore:

Shkallë e argumentimit të fjalimit (sa argumente ka në çdo diskutim);

Shkallë e respektimit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumenteve të tyre;

Transparencë për pranimin e argumenteve të huaja dhe ndryshimi i qëndrimeve të veta për shkak të argumenteve më cilësore të paraqitura në debatin;

Nëse deputetët i arsyetojnë qëndrimet në emër të interesave të kujt i përfaqësojnë qëndrimet e veta;

Vallë a mund deputetët në mënyrë të papenguar ti shfaqin qëndrimet e veta.

Me monitorimin janë përfshirë debatet të cilat kanë të bëjnë me pika të rendit të ditës të ndërlidhura me temat: sundimi i të drejtës, të drejtat dhe liritë e njeriut, integritet evropiane, financat publike

dhe të tjera për të cilat do të konstatohet se janë në interes për hulumtimin. Në atë drejtim përcillen seancat plenare të Kuvendit dhe të trupave punuese vijuese:

Komisioni për financim dhe buxhet;

Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive;

Komisioni për zgjedhje dhe emërimë;

Komisioni për vetëqeverisje lokale;

Komisioni për çështje evropiane;

Komisioni anketues për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të qytetarit;

Komisioni ligjdhënës – juridik;

Trupe të tjera punuese.

## Projekti Kuvendi nën thjerrëz

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz” është i financuar nga Agjencia zvicerane për përkrahje dhe zhvillim. Në pjesën e aktiviteteve përfshin monitorim 28 mujor të cilësisë së debatit kuvendor dhe monitorim të asaj se si mediet raportojnë për punën e Kuvendit.

Monitorimi i debatit kuvendor dhe i raportimit mediatik filloi në shtator të vitit 2015 dhe do të zgjas deri në dhjetor të vitit 2017 dhe do të përfshijë analizë dhe raportim për njohuritë e përfituara nga monitorimi në çdo tre muaj. Në periudhën e projektit do të përpilohen 9 raporte tremujore për cilësinë e debatit në parlamentin dhe 9 raporte tremujore për raportimin mediatik për punën e deputetëve. Në kuadër të projektit do të zbatohen dhe do të shpallen rezultatet e dy hulumtimeve në terren të opinionit publik për perceptcionet e qytetarëve për punën e Kuvendit.

Projekti paraqet vazhdimësi i projektit “Kuvendi nën thjerrëz përforcimi i debatit politik dhe diskursi deliberativ” i cili u financua nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – EIDHR dhe u realizua në periudhën nga muaji shkurt i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2015.

MK

Nr. 0809-018/17

Shkup, 23.01.2017



# Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvendin

korrik - tetor 2016



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Институт за демократија  
Социетас цивилис - Скопје